



01-2570/18

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, nenit 13 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Administrative, nr. 02/L-28 dt. 22.07.2005, nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 57 pika "c" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës me nr. **05-350/02-0274726/18 dt. 16.11.2018** të Ilir Gllareva dhe Arif Beqiri, Rr. Ilaz Kodra, Hyrja 4, nr.6, Skenderaj për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë në bllokun "L-44" të tërësisë urbane "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 17.04.2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore Ilir Gllareva dhe Arif Beqiri, nga Skenderaj, sipas kërkesës me nr. **05-350/02-0274726/18 dt. 16.11.2018**, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitet B+P+1, në kuadër të parcelës ndërtimore "L-44-7" të bllokut urban "L-44" të tërësisë urbane "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, në parcelen kadastrale nr. 00259-15, Z.K Çagllavicë.

II. Lokacioni, i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, gjendet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë për ndërtim individual. Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronari është informuar me "Informim nga Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", përmes sistemit online, me nr. të referencës 16356 të dt.17.05.2018.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 259-15, me $S = 700 \text{ m}^2$, me pronar Ilir Gllareva (450/700) dhe Arif Beqiri (250/700) "tokë bujqësore e klasës IV-të".
 - Sipas gjendjes faktike dhe certifikatës së pronësisë 450 m^2 janë pronë e Ilir Gllareva ndërsa 250 m^2 janë pronë e Arif Beqirit i cili njëkohësisht është edhe pronar i parcelës fqinje nr.259-16. Sipas zgjidhjes urbane me ndarje dhe bashkim janë propozuar tri parcela me nga 450 m^2 .
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Parcela kadastrale nr. 259-15, shtrihet në dy parcela ndërtimore (L-44-7 dhe L-44-9) të parapara sipas planit të riparcelimit, në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim".
- Sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re- Zona Perëndim" 64 m^2 të parcelës kadastrale 259-15 kalojnë në rrugën e planifikuar.
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka një ramje të lehtë në raport me rrugën;
- Parcela kadastrale ka qasje në rrugën ekzistuese dhe rrugën e planifikuar sipas këtij Plani Rregullues;
- Qasja e parcelës deri në rrugën kryesore publike arrihet përmes rrugës ekzistuese në terren.
- Në diametër prej 50 m ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual.

- Parcela kadastrale me nr. 259-15 , sipas planit te parcelimit, shtrihet pjesërisht në parcelën ndërtimore "L-44-7" dhe pjesërisht në parcelën ndërtimore "L-44-9" të bllokut urban "L-44" të tërësisë hapësinore "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë. Një pjesë e parcelës nr. 259-15 përfshihet në rrugën e planifikuar.
- Bashkëpronari i parcelës kadastrale nr. 259-15, Arif Beqiri, njëkohësisht është edhe pronar i parcelës kadastrale fqinje me nr.259-16 e cila shtrihet në dy parcela ndërtimore L-44-9 dhe L-44-11, sipas planit rregullues.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, gabariti i ndërtesës, pozicionimi i objektit dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore, të jenë në tërësi sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike në përpjesë 1:500, e që është pjesë përbërëse e këtyre Kushteve Ndërtimore;
 - Etazhiteti maksimal i objektit të jetë P+2, i propozuar B+P+1.
 - Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP) duhet të jetë 40% e sipërfaqes së parcelës ndërtimore. Në rastin konkret 40% e parcelës ndërtimore të propozuar për ndarje (sipërfaqja brenda vijës rregulluese) që përfshihet në parcelën kadastrale 259-15, në bazë të "Situacionit të parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.
 - Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN) të jetë max. 450 m²;
 - Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN) duhet të jetë 60%;
 - Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISGJ) duhet të jetë 25%;
 - Destinimi i shfrytëzimit të objektit të jetë për banim individual;
 - Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga lokale ekzistuese, njëkohësisht rrugë e planifikuar sipas Planit Rregullues;
 - Distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m`;
 - Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj., nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0 m` nga parcela fqinje;
 - Kuota e nivelit të përdhësës 0.45 m mbi nivelin e trotuarit;
 - Në një parcelë ndërtimore, përveç ndërtesës kryesore, mund të ndërtohen edhe objektet ndihmëse që formojnë tërësi banimi apo tërësi ekonomike (si p.sh. garazhat, etj);
 - Në kuadër të objektit ose parcelës ndërtimore të parashihen dy garazha apo dy vendparkingje.
 - Rrethojat kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përskaaj rrugës ka lartësi prej max 1.5 m, ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0 m;
 - Arkitektura e objektit të ri ti përshtatet ambientit që e rrethon, vlerave ambientale, duke pasur kujdes në harmonizimin e vertikalisitetit dhe horizontalitetit të volumit të ndërtesës dhe me karakteristika të kulturës urbane;
 - Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale;
- **Te gjitha kopjet e pelqimeve dhe deklaratat që i janë bashkangjitur dokumentacionit, në fazën e lejes ndertimore duhet të dorëzohen në kopje origjinale.**

V. Ndarja/ parcelimi i parcelës kadastrale nr. 259-15 Z.K Çagllavicë, do të realizohet sipas zgjidhjes urbane, të miratuar me këto kushte ndërtimore, përcaktuar me manualin e ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar. Gjithashtu bashkimi i pjesës së parcelës nr. 259-15 pronë e Arif Beqirit me parcelën 259-16 e më pas ndarja sipas zgjidhjes urbane.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartëcekur, sipas zgjidhjes urbane. Procedura e ndarjes /parcelimit, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve. Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit duke u bazuar në Planin e situacionit - "Zgjidhjen Urbane".

I. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

II. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 02678-12 ZK Prishtinë në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "IV", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – “zgjidhja urbane”, duke llogaritur sipërfaqen e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulative të përcaktuar me Planin rregullues. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesit Ilir Gllareva dhe Arif Beqiri nga Skenderaj, me kërkesën nr. 05-350/02-0274726/18 dt. 16.11.2018, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitet B+P+1 në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtyre Kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesit kanë prezantuar: provën mbi të drejtën pronëso-ro-juridike në lokacionin në fjalë, për parcelën kadastrale nr. 00259-15, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914075-00259-15 Z.K Çagllavicë të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, vërtetimin e tatimit në pronë nr.274699/18 dt.16.11.2018 në emër të Arif Beqiri, vërtetimin e tatimit në pronë nr.274697/18 dt.16.11.2018 në emër të Ilir Gllareva, Informimin nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, me nr. të referencës 16356 të dt.17.05.2018, inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale nr.259-15 të punuar nga Agon Blakaj – CADCOM sh.p.k, me nr.të licencës 34, projekt propozimin për kushte ndërtimore, Deklarata-Pëlqimi i Hajdar Fejzullahut dhe Lutfije Fejzullahut, bashkëpronar të parcelës fqinje 00259-14 që pajtohet me cilëndo zgjidhje për ndërtim të fqiut të tij si dhe lirshëm të ndërtoi në distanc prej 1(një) metri,(ky dokument është vërtetuar te noteri Nr.LRP 12221/2018 dt.14.11.2018), Deklarata – pëlqimi i Qemail Jusufit, pronar i parcelës fqinje 260-1 per zgjidhjen e propozuar nga fqinjët dhe pëlqimin për lejimin e ndërtimit në distancë prej 1m, (kopje e dërguar me E-mail nga SH.B.A me dt. 08.01.2019), Deklarata – Kopje e Pëlqimit Nr.LRP-së 11122/2018 i Ilir Gllareva dhe Arif Beqiri se pajtohen me cilëndo zgjidhje në favor të parcelës fqinje 00259-14 duke lejuar distancën e ndërtimit 1,00m, Kopje e Pëlqimit LRP.Nr. 349/2019 dt.25.01.2019 i Arif Beqirit pronar i parcelës 259-16

se fqiu i tij Qemal Jusufi mund të ndëton shtëpinë në distacë prej 1m, në parcelën e tij me nr.260-1 Z.K Çagllavicë, Kopje e Aktit të pranuar nën betim Nr.i LRP-së 3094/2019, REF.nr. 590/2019 dt. 19.03.2019 i Bajram Gashanit, se si pronar i parcelës kadastrale 00259-17 e cila sipas gjendjes faktike është rrugë, do të shfrytëzohet si rrugë dhe se nuk do të kërkon të hyjë në ndërtim me pjesën e kësaj parcele - trekëndëshi brenda parcelës ndërtimore L-44-11, kopja e letërnjoftimit e Ilir Gllareva dhe Arif Beqiri.

Me shkresen nr. 05-350/02-0274726/18 dt. 18.12.2018 per "Plotesim dokumentacioni" është kerkuar nga pronari, plotesimi i pikave si ne vijim:

- Zgjidhja Urbane për parcelat kadastrale 259-15 dhe 259-16 sipas propozimit për ndarje dhe bashkim, të bashkangjitur në dokumentacion.
- Pëlqimi – deklarata e ndërsjellë në mes te pronarëve të parcelave 259-16 dhe 260-1 se pajtohen per lëvizjen e vijës kufizuese të parcelës ndërtimore, sipas parcelave kadastrale, përkatësisht gjendjes faktike si dhe pëlqimi për ndërtim – nëse planifikohet të ndërtohet në distancë më të vogël se 3m.
- Pëlqimin-deklaratën nga pronari i parcelës kadastrale, që sipas gjendjes faktike është rrugë - këndi në mes të rrugës Mehshari dhe Parga, e që sipas Planit Rregullues, pjesërisht përfshihet brenda parcelës ndërtimore L-44-11, që kjo parcelë të shfrytëzohet si rrugë (duke përfshi edhe sipërfaqen në formë trekëndëshi) sipas gjendjes faktike, përkatësisht pronari te deklaronte se hjekë dorë nga ndërtimi për këtë parcelë.

Meqenese pala nuk ka arrite t'i plotesoje te gjitha keto dokumente brenda afatit prej 8 (tete ditesh), me shkresen nr. 05-350/02- 0274726/18 dt. 27.12.2018 ka kerkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, shtyrje te afatit te vendosjes se kerkeses 05-350/02-0274726/18 dt. 16.11.2018 . Kjo kerkese eshte miratuar nga ana e ketij organi me dt. 18.01.2019.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, ka konstatuar se propozimi për kushte ndërtimore është konform kriterëve të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal me nr. 01 Nr. 35-186850 të dt. 02.10.2013, nenit 17 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012 si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, konsultimit të planeve urbanistike për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e këtyre Kushteve Ndërtimore.

Shtojcë: Shtojcë: Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në Sistemin Koordinativ KosovaRef01 dhe Plani i situacionit - "zgjidhja urbane",

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këto Kushte Ndërtimore, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre Kushteve ndërtimore.

I dërgohet: Kërkuesit, kësaj Drejtorie, në dosjen e lëndës dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
NR. . 05-350/02-0274726/18 DT. 17.04.2019**

Zyrtari,

Mejrushe Sejdullahu

u.d Udhëheqëse e Sektorit

Lindita Beqiri






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 17.04.2019

Legjenda:

-  Vija Rregulluese sipas PRRU
-  Vija Ndërtimore sipas PRRU
-  Parcela Kadastrale

